

V E N D I M
Nr.620, datë 6.11.1995

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE

Në mbështetje të nenit 1 të ligjit nr.8008, datë 5.10.1995 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7710, datë 18.5.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”, me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Për të përcaktuar nivelin maksimal të ndihmës ekonomike të plotë mujore, merret në konsideratë niveli bazë i pagesës së papunësisë.

2. Niveli maksimal i ndihmës ekonomike të plotë mujore që përfitonë familja, nuk mund të jetë më i madh se 250 për qind të nivelit bazë të pagesës së papunësisë.

3. Masa e ndihmës ekonomike të plotë mujore për familjen përbëhet nga dy pjesë dhe llogaritet nga shuma aritmetike e tyre. Pjesët përbërëse të saj janë :

a) shuma bazë, e cila i jepet vetëm kryefamiljarit dhe nuk mund të jetë më e madhe se 95 për qind e nivelit bazë të pagesës mujore të papunësisë;

b) një përqindje mbi shumën bazë, për çdo anëtar tjetër të familjes, sipas këtyre përmasave:

- jo më shumë se 100 për qind e kryefamiljarit, nëse anëtari është mbi moshë pune, ose i paaftë fizikisht a mendërisht:

- jo më shumë se 20 për qind e kryefamiljarit, nëse është në moshë pune;

- jo më shumë se 25 për qind e kryefamiljarit, nëse është nën moshën e punës.

3. Këshilli i bashkisë dhe komunës vendos për masën e ndihmës ekonomike që përfitonë familja, duke u mbështetur në këta tregues:

a) fondin e akorduar nga Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë;

b) vendimin e Këshillit të Ministrave nr.605, datë 30.10.1995 “Për kriteret e vlerësimit të ndihmës ekonomike”;

c) kriteret specifike lokale;

ç) nivelin maksimal të ndihmës ekonomike mujore të përcaktuar në pikën 2 dhe 3 të këtij vendimi.

4. Kriteret specifike lokale përcaktohen nga këshillat e bashkive dhe komunave, por ato nuk mund të jenë në kundërshtim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.605, datë 30.10.1995, si dhe nuk mund të mbështetin tejkalimin e buxhetit të arkoduar për ndihmë ekonomike.

5. Ndihma ekonomike mujore e pjesshme, që përfitonë familja, është diferencë ndërmjet nivelit maksimal të ndihmës ekonomike mujore të plotë dhe të ardhurave aktuale të familjes, në të cilat hyjnë:

a) të ardhurat nga veprimtaria ekonomike;

b) të ardhura nga çdo sistem i mbrojtjes shoqërore, shtetërore, ose private, ose individual;

c) nga kapitali;

ç) nga anëtar i familjes jashtë shtetit;

d) nga toka (përveç tokës në proces shfrytëzimi);

dh) nga bagëtia;

e) nga kafshët dhe shpendët;

ë) nga vreshtat, kopshtaria dhe mbajtja e bletëve.

6. Niveli maksimal i ndihmës ekonomike mujore të plotë ndryshon në përputhje të plotë me ndryshimin e nivelit bazë të pagesës mujore të papunësisë, sipas udhëzimit të Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë.

7. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.453, datë 26.9.1994, pikat 1, 2, 3 shfuqizohen.

8. Ngarkohen Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit të nxjerrin udhëzimet e nevojshme në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 dhjetor 1995.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi